Biljana Kamçevska
Zhaklina Ristovska
Aneta Trifunovska Stojanova
Maria Josheska
Irena Pantova

SHOQËRIA

1

për klasën I në arsimin fillor
nëntëvjeçar

Biljana Kamçevska
Zhaklina Ristovska
Aneta Trifunovska Stojanova
Maria Josheska
Irena Pantova

SHOQËRIA

për klasën I në arsimin fillor nëntëvjeçar

SHOQËRIA 1
për klasën I në arsimin fillor nëntëvjeçar

Botues:
Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
rr. “Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Autore:
Biljana Kamçevska
Zhaklina Ristovska
Aneta Trifunovska Stojanova
Maria Josheska
Irena Pantova

Recensentë:
Marieta Petrova
Svetllana Josifoska
Vesna Nedanovska

Ilustrimet:
Janë përdorur ilustrime nga baza e Prosvetno dellos dhe Shutterstock

Titulli i origjinal:
Општество 1 за I одделение во деветгодишно основно образование
Билјана Камчевска
Жаклина Ристовска
Анета Трифуновска Стојанова
Марија Јошеска
Ирена Пантова

Redaktor: Refail Sulejmani

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Refail Sulejmani

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe: Solidar Sulejmani

Lektor: Refail Sulejmani

Rregullimi grafik dhe teknik:
Leon Xhingo, Evgenija Pavllova – ARS STUDIO

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023

Me Vendim për miratimin dhe përdorimin e tekstit shkollor në lëndën Shoqëria për klasën I në arsimin fillor nëntëvjeçar nr. 26-352/1 të datës 8.02.2023, të sjellë nga Komisioni kombëtar i teksteve shkollore.

I dashur nxënës i klasës së parë,

Këtë vit do të jetë sfidë për ty, që të fitosh shumë njohuri dhe përvoja të reja. Libri shkollor "Shoqëria" do të të ndihmojë në këtë. Në të ka përmbajtje, figura dhe aktivitete interesante përmes të cilave do ta njohësh më mirë veten, por edhe të tjerët rreth teje, do të njihesh me shkollën, rrethinën e afërt dhe rregullat e trafikut. Gjithashtu, do të fitosh shkathtësi të reja, do të mësosh të zbatosh rregullat e sjelljes në shkollë, në shtëpi dhe në mjedisin ku jeton, do të zhvillosh shprehi higjienike dhe kulturore dhe do të bëhesh nxënës i mirë, i përgjegjshëm dhe i vyeshëm.

Shpresojmë se teksti shkollor do ta kënaqë kureshtjen tënde dhe do të të inkurajojë të zbulosh dhe të hulumtosh shumë gjëra të reja.

Të dëshirojmë mësim të suksesshëm!

Nga autoret

Simbolet

Trego, fol, përgjigju, emërto, përshkruaj

Pyetje

Lojë

Aktivitet në grup

Hulumto

Mendo

Dramatizo

Format si mësimdhënës, nxënës e të ngjashme përdoren në mënyrë neutrale dhe kanë të bëjnë me të dyja gjinitë (mashkullore dhe femërore), sepse në këtë mënyrë teksti nuk rëndohet me forma si mësues/mësuese, nxënës/nxënëse, i mirë/e mirë etj.

TEMA 1

UNË JAM FËMIJË

Në këtë temë do të mësojmë për:

- Kush jam unë?
- Çfarë më pëlqen te vetja
- Çfarë mund të bëj tani dhe çfarë do të mund të bëj në të ardhmen
- Ndjenjat e mia
- Shokët dhe shoqet e mia

Kush jam unë?

Unë jam
Lina Stojanova.

Përshëndetje!

Kam 6 vjet.
Jam lindur më
18 shkurt.

Jetoj në Shkup në
adresën:
bul. “ASNOM” nr. 22.

Më së shumti dua
të vizatoj.

Shpesh ngas biçikletë
buzë lumit Vardar.

Ngjyra ime e
preferuar është e
verdha.

I njoftove Linën dhe Filipin dhe i mësove të dhënat e tyre personale.
Tani prezantohu edhe ti.

Cila është adresa dhe vendbanimi ku jeton?
Pse duhet të dish adresën tënde të banimit?

Përshëndetje!

Unë jam Filip Nikollovski.

Kam 6 vjet. Ditëlindja ime është më 4 prill.

Jetoj në Manastir në rrugën "Përvomajska" nr. 15.

Shumë dua të shoqërohem me shokët e mi.



Sporti im i preferuar është basketbolli dhe çdo ditë luaj jashtë me shokët e mi.

Dua të udhëtoj dhe gjithmonë jam i lumtur kur e vizitoj qytetin e Ohrit.

Çdo fëmijë ka të dhënat e veta personale:

emri dhe mbiemri

adresa e vendbanimit

data e lindjes

Ditëlindja ime

Përshkruaj çfarë ndodh në figurë.
Trego si e feston ditëlindjen tënde.

Kur është ditëlindja jote?
Çfarë do të doje të marrësh si dhuratë për ditëlindje?

Mëso kur është ditëlindja e shokut tënd.

Muajt e vitit



Një vit ka 12 muaj.
Muajt radhiten njëri pas tjetrit,
kur mbaron njëri, fillon tjetri.

Numëro muajt e vitit. Ki kujdes gjatë renditjes së tyre!

Me cilin muaj fillon dhe mbaron viti?
Cili muaj është tani në vazhdim?
Në cilin muaj është ditëlindja jote?



Numëro muajt në të cilët janë lindur shokët e tu. Sipas radhitjes së tyre, zbulo kush është më i vogël, e kush është më i madh se ti.

Lojë e propozuar: Qëllo muajin.

Çfarë më pëlqen te vetja?

Çdo fëmijë është i veçantë dhe ka cilësitë e veta.

Ana është vajzë e mirë. I ndihmon të moshuarit kur kanë nevojë për ndihmë.

Marku është shok bujar.

Emiri e rregullon dhomën e tij vetë. Ai është i vlefshëm.

Unë jam punëdashës dhe me kohë i kryej obligimet shkollore.

- Shiko figurat dhe diskuto për veprimet e fëmijëve.
- Cilat cilësi të pëlqejnë te vetja jote?
  A je fëmijë i besueshëm?
  Me çfarë veprimesh tregon se je fëmijë punëtor?
- Trego për ndonjë situatë kur ke ndihmuar dikë që kishte nevojë për ndihmë.

Sania e ushqen rregullisht kafshën e saj përkëdhelëse. Ajo është vajzë e kujdesshme.

Unë jam shumë i kujdesshëm kur e kaloj rrugën. Pres që të hapet ngjyra e gjelbër e semaforit.

Sania, gjithashtu, është nxënëse e përgjegjshme. Ajo ngrihet në kohë për në shkollë.

Ana është shoqe e besueshme. Ajo di të mbajë fshehtësi.

Mendo dhe krahaso cilësitë e tua pozitive me cilësitë e shokut tënd.

Lojë e propozuar: Cilësitë tona pozitive.

Çfarë mund të bëj tani dhe çfarë do të mund të bëj në të ardhmen

TANI

NË TË KALUARËN

NË TË KALUARËN

TANI

TANI

NË TË KALUARËN

Përshkruaj çfarë ndodh në figurat.

Kujtohu çfarë mund të kishe bërë në moshë më të re.

Çfarë mund të bësh tani, kurse nuk kishe mundur të bëje në të kaluarën?

Nxënësit ndahen në disa grupe.
Secili nxënës në grup tregon se çfarë dinte të bënte në mënyrë të pavarur kur ishte më i ri dhe çfarë ka mësuar të bëjë tani, nëpërmjet njohurive që marrë deri tani.

Çfarë mund të bëj tani?

Çfarë do të mund të bëj në të ardhmen?

Shiko dhe krahaso figurat.
Cili është ndryshimi midis asaj që bëjnë fëmijët më të vegjël dhe më të mëdhenj?

Çfarë do të bësh tani, por nuk mundesh për shkak të moshës?
Çfarë dëshiron të dish që të bësh në të ardhmen?

Sikurse rritem, mund të bëj më shumë gjëra:

- vishem vetë
- mbaj higjienën personale
- kujdesem për gjërat e mia
- rregulloj dhomën time
- luaj lojëra interesante me shokët etj.

Ditët e javës (dje, sot, nesër)

Fëmijët në figura kanë aktivitete në ditë të caktuara të javës.

E hëna
është dita e
parë e javës.

E marta
është dita e
dytë e javës.

E mërkura
është dita e
tretë e javës.

E enjtja është
dita e katërt
e javës

1

2

3

4

Java

E shtunë + e diel

Trego me radhë ditët e javës.
Cila është dita e parë dhe e fundit e javës?
Cila ditë është e shënuar me numrin 3?

Shiko figurat dhe cakto çfarë dite është sot.
Përshkruaj çfarë bën fëmija në figurë.

E premtja
është dita e
pestë e javës.

5

E shtuna është
dita e gjashtë
e javës.

6

E diela është
dita e shtatë
e javës.

7

(shtatë ditë)

= fundjavë

Cili është aktiviteti yt shtesë dhe në cilën ditë të javës e kryen atë?

Nëse nesër është e martë, cila ditë është sot?
Nëse dje ishte e enjte, cila ditë është sot?
Nëse sot është e premte, kur fillon fundjava?

I zhvilloj shkathtësitë dhe aftësitë e mia

Çfarë bën në kohën tënde të lirë?
Cili është sporti yt i preferuar?

Fëmijët në figurat më lart i zhvillojnë me sukses shkathtësitë dhe aftësitë e tyre. Mendo si arrijnë sukses në atë që duan ta bëjnë.

Cila shkathtësi të pëlqen dhe si e ke mësuar atë?
Çfarë duhet të bësh për të arritur sukses?
Cili është kërcimi yt i preferuar?

Shkoj në stërvitje basketbolli tri herë në javë.

Dëshira ime është të jem basketbollist i njohur.

Në trajnime kam takuar shumë shokë të rinj.

Shpesh fitojmë ndeshje si ekip.

Ushtroje me këmbëngulje atë që dëshiron ta bësh dhe mos u dorëzo.
Kështu do të arrish sukses.

Gara e pazakontë

Miu donte shumë të ishte i pari në gjithçka. Vendosi t'i jepte maces një peshk, kurse në këmbim të fitonte garën e pazakontë. Macja pranoi ofertën dhe e la miun të fitonte.

Gara filloi. Miu arriti i pari në cak. Shumë u gëzua për fitoren. Macja, në anën tjetër, ishte e kënaqur që mori peshk, edhe pse nuk fitoi.

Mendo për veprimet e miut dhe maces.

Kush gaboi dhe pse?
Si do të veproje ti në situatë të këtillë?
Sipas teje kush duhet të fitojë në garë?





Në oborrin e shkollës ose në sallën sportive luani rolet e maces dhe të miut. Në lojë përmirësoni veprimet e tyre të gabuara. Le të fitojë ai që është më i mirë.

Ndjenjat e mia

Çfarë është ndjenja?

Diçka nga brenda.	Diçka që kam në zemër.	Diçka që e dalloj nga fytyra.	Diçka që më bën të sillem ndryshe.

Në jetën e përditshme njerëzit gjenden në situata të ndryshme.
Nëpërmjet shprehjes së fytyrës ata tregojnë se si ndihen.

Shiko fytyrat e fëmijëve më lart. Çdo shprehje tregon ndjenja të ndryshme.
Sipas shprehjes njihi dhe emërtoji ndjenjat e tyre.

Përshkruaj situata në të cilat ndjen gëzim, pikëllim, frikë ose zemërim.



FRIKË

ZEMËRIM

Shiko figurat, mendo dhe përgjigju.

Në cilën figurë e dallon gëzimin?
Pse fëmija qan? Si do të ndiheshe në situatë të tillë?
Si e njohe frikën e fëmijës?
Në figurën e fundit fëmijët janë të zemëruar. Pse?

Çdo fëmijë ka ndjenja. Fëmijët i shfaqin ndjenjat e tyre përmes GËZIMIT, PIKËLLIMIT, FRIKËS dhe ZEMËRIMIT.
Ndjenjat paraqiten çdo ditë në situata të ndryshme.

Si ndihem kur...

Si ndihet fëmija, të cilit i është marrë topi?
Si është ndjenja e zemërimit?
Si sillesh kur je i zemëruar?

Çfarë ndjenje paraqitet te fëmija, i cili e theu dritaren?
Pse fëmija është i frikësuar?
Nga çka frikësohesh ti?

Çfarë shkaktoi dhurata te fëmija?
Çfarë të bën të gëzuar ty?
Çfarë bën kur je i gëzuar?

Çfarë e pikëlloi fëmijën?
Cila është shenja më e shpeshtë në fytyrën e fëmijës kur është i pikëlluar?
Si kalohet pikëllimi?

Lojë e propozuar: Eja t'i tregojmë ndjenjat!

Çka është dashuria?

Dashuria është ndjenjë e mirë.
Dashuri tregojmë kur duam fort dikë ose diçka.

KAFSHË

FAMILJE

ATDHE

LIBËR

NATYRË

SHOKË

BIMË

Ndaj kujt ndjen dashuri?
Ku e ndjen dashurinë?

Si tregohet dashuria?

Si e tregon dashurinë? Cilat fjalë, lëvizje dhe veprime i përdor?

SHOQËRIA

Shoqëri është kur
shoku me shokun shoqërohen.
Në shoqëri nga secili dashuri e
vëmendje dhurohet.

Shoqëri është kur në pushim
ushqimi ndahet.
Por, shoqëria tregohet
edhe kur çdo fshehtësi mbahet!

SHOQËRIA ËSHTË GËZIM,
PA SHOKË ËSHTË PIKËLLIM!

Në shoqëri gjithmonë thuhet
fjalë e bukur dhe e mirë.
Në shoqëri gjithçka zgjidhet
me mirëkuptim dhe
marrëveshje.

Çka është shoqëria?

Si duhet të jetë shoku i mirë?
Çfarë shoku je ti?

Përshkruaj çfarë ndodh në figurë.

Në cilat situata e njeh shoqërinë?

Shiko figurat dhe trego për veprimet e shoqes së mirë.

Shoku i mirë: ndihmon, ndan, do, ruan fshehtësi,
luan, merret vesh, respekton rregulla.

Eja të luajmë dhe të shoqërohemi

Çfarë bën kur je jashtë me shokët e tu? Cilat lojëra i luani së bashku? Si ndihesh duke luajtur?

Shiko figurat. A njeh ndonjë nga lojërat të cilat i luan ti? Përshkruaje lojën që të pëlqen të luash më shumë.

ÇFARË MËSOVA

VLERËSO VETEN TËNDE

Ngjyrose yllin sipas suksesit të arritur.

Unë di dhe mundem.

Duhet të punoj pak më shumë.

Kam nevojë për ndihmë.

- Di të prezantohem.
- E di kur është ditëlindja ime.
- I numëroj muajt e vitit sipas radhitjes së tyre.
- I njoh cilësitë pozitive te vetja ime.
- E dalloj të tashmen nga e kaluara dhe e ardhmja.
- I emërtoj ditët e javës.
- Mund të caktoj se cila ditë paraprin dhe cila pason.
- E di se duke bërë shumë përpjekje mund të zhvilloj shkathtësitë dhe aftësitë e mia.
- Mund të dalloj veprime të gabuara.
- I njoh ndjenjat e gëzimit, pikëllimit, zemërimit dhe frikës te të tjerët. Di t'i shpreh ndjenjat e gëzimit, pikëllimit, zemërimit dhe frikës në situata të caktuara.
- Di mënyra të ndryshme se si mund të tregohet dashuria.
- Mund të njoh veprimet e shokëve të mirë.

TEMA 2
UNË JAM NXËNËS

Në këtë temë do të mësojmë për:

- Klasën tonë dhe shkollën tonë
- Ne nxënësit dhe mësuesi ynë / mësuesja jonë

Klasa dhe shkolla jonë

Unë jam nxënës

Si u ndjeve në ditën e parë të shkollës?
Cila klasë je tani?

Përshkruaje figurën. Në cilën shkollë mësojnë Marku dhe Maria?
A janë nxënës në të njëjtën klasë?

Në cilën shkollë dhe klasë mëson ti?
Sa nxënës ka në klasën tënde?
Pse duhet të shkosh në shkollë?

Përshkruaj si e kalon një ditë shkollore.

Në shkollë mësojmë të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin dhe të fitojmë njohuri dhe shkathtësi.

Çfarë dëshiron të mësosh në shkollë? Cila është lënda jote e preferuar?
Si mëson më mirë, vetëm apo në grup me nxënës të tjerë?
Cilat lojëra më shumë i luani me shokët e klasës gjatë pushimeve në oborrin e shkollës?

Klasa ime

Si duket klasa jote?
Çfarë mungon në të?

Shiko dhe përshkruaj klasën në figurë.
Çfarë këndesh ka në klasë?
Çfarë është vizatuar në dërrasën e zezë në klasë?
Çfarë ka në EKO këndin?

Numëro çfarë ka në klasën tënde?
Pse e përdor dërrasën e zezë në klasë?
Ku i var vizatimet me shokët e tu?
A ka në klasën tënde kënd shkencor dhe çfarë përmban ai?
Çfarë librash me ilustrime gjenden në bibliotekën tënde të klasës?

Klasa është hapësira jonë e përbashkët, në të cilën të gjithë mësojmë dhe shoqërohemi së bashku.

Hapësirat në shkollë

Në cilën hapësirë të shkollës mëson dhe e kalon pjesën më të madhe të ditës në shkollë?
Si quhet hapësira në shkollë ku e mban higjienën personale?

KLASA



ZYRA E ARSIMTARËVE

BIBLIOTEKA E SHKOLLËS

TUALETET



SALLA E SPORTIT

KORRIDORI

TRYEZA E SHKOLLËS

SALLA E SHKOLLËS

Çfarë hapësira ka në shkollën tënde?
Cilat hapësira në shkollë i përdor dhe pse?
Hulumto a është lehtësisht e afrueshme shkolla jote për të gjithë fëmijët.

Shiko figurën dhe trego nga cila hapësirë del fëmija?
Pranë cilave hapësira kalon fëmija për të arritur në oborrin e shkollës?
Përshkruaje rrugën nga klasa jote deri në oborrin e shkollës.

Lojë e propozuar: Ndiqi udhëzimet dhe mbërri te caku.

Si kujdesemi për klasën, shkollën dhe oborrin e shkollës?

Nxënësit dhe mësimdhënësit së bashku kujdesen
për higjienën dhe rregullimin e klasës.

Përshkruaj çfarë bëjnë nxënësit dhe mësuesja në figurë.

Si kujdesesh për higjienën në klasë?
A ndihmon ti në rregullimin e saj? Pse?
Çfarë ke bërë sot për ta mbajtur klasën të rregulluar dhe të pastër?

Nëse dëshiron që klasa të duket më e bukur, çfarë do të ndryshosh?

Përshkruaj çfarë ndodh në figurat.

Pse është e rëndësishme që shkolla dhe oborri të jenë të pastra dhe të rregulluara? Çfarë do t'i thoshit shokut nëse ai do të hidhte mbeturina në dysheme?

Së bashku me fëmijët e klasës tënde organizoni eko-aksion për të rregulluar oborrin e shkollës dhe për të mbjellë fidanë të rinj.

Rregullat dhe përgjegjësitë e shkollës

Rregullat në klasë

NËSE I DËGJON ME KUJDES UDHËZIMET E MËSIMDHËNËSIT, DO TË DISH SI TË VEPROSH.

DO TË ISHTE MIRË TË KUJDESESH PËR HIGJIENËN NË KLASË.

NË SHKOLLË DUHET TË VISH NË KOHË.

NGA LIBRAT MËSOJMË, PRANDAJ RUAJI ATO.

KUR DO TË THUASH DIÇKA, NGRE DY GISHTA.

PËRPIQU TA MBASH BANKËN TËNDE TË RREGULLUAR DHE TË PASTËR.

Rregullat në shkollë

ËSHTË MIRË TË MARRËSH PJESË NË ZBUKURIMIN E KORRIDORIT TË SHKOLLËS.

NË KORRIDORET E SHKOLLËS NUK DUHET TË VRAPOHET.

MUND TË KUJDESESH PËR BIMËT NË SHKOLLË.

BËHU I SINQERTË DHE SHOK I MIRË DHE MOS E LËNDO SHOKUN TËND.

MOBILJET E SHKOLLËS NUK DUHET TË SHKATËRROHEN.



MBETURINAT HIDHI NË KOSHIN E PLEHRAVE.

Rregullat në oborrin e shkollës

KUJDESU QË OBORRI I SHKOLLËS TË JETË I PASTËR DHE I RREGULLUAR.

MBETURINAT E NDARA HIDHI NË KOSHIN E SHËNUAR PËR LETËR, PLASTIKË OSE QELQ.

NUK DUHET TË SHKATËRROHEN LULET, PEMËT DHE BIMËT E TJERA NË OBORR.

NDIHMOJI SHOKUT TËND.



KI KUJDES SI FLET, MOS PËRDOR FJALË TË TURPSHME.

MOS HIDH MBETURINA NË OBORRIN E SHKOLLËS.

LUAJ NË OBORRIN E SHKOLLËS, MOS U NGACMO.

ËSHTË MIRË TË KONTRIBUOSH DUKE MBJELLË LULE DHE PEMË NË OBORRIN E SHKOLLËS.

Bisedoni në klasë për rregullat e sjelljes në shkollë, klasë dhe oborr të shkollës.

Çfarë do të ndodhë nëse nxënësit nuk i respektojnë rregullat e sjelljes?

Përcaktoni edhe rregulla të tjera të sjelljes dhe bëni poster.
Vendosni ato në vend të dukshëm në shkollë.
Gjëja më e rëndësishme është që rregullat të respektohen.

Festa e patronatit të shkollës

Si ndihesh kur feston diçka?

A ke marrë pjesë në ngjarje solemne?

Përshkruaj atë që sheh në figurë.
Çfarë është festa e patronatit?
Kush merr pjesë në përgatitjen e saj?

Zbulo kur është festa e patronatit të shkollës tënde dhe si festohet.

Çdo shkollë ka festën e saj të patronatit. Atë ditë nxënësit dhe mësimdhënësit marrin pjesë së bashku në përgatitjet për shfaqjen e shkollës dhe e festojnë atë në mënyrë solemne.

Ne nxënësit dhe mësimdhënësi ynë

Mësimdhënësi im



- Cilat lëndë janë shkruar në tabelën e figurës?
- Cilat lëndë i mëson me mësimdhënësin tënd?
- Cili është roli i mësimdhënësit në shkollë?
- Çfarë u mëson mësimdhënësi nxënësve të tij?

Çfarë këshilla dhe udhëzime u jep mësimdhënësi nxënësve?

Në shkollë, përshëndetu dhe sillu me mirësjellje.

Kujdesu për pajisjet e tua shkollore.

Dëgjo me kujdes udhëzimet e mësimdhënësit dhe vepro sipas tyre.

Përfundo në kohë detyrat e dhëna.

Nëse dëshiron të thuash diçka, ngre dorën.

Dëgjo me kujdes kur personi tjetër flet.

Ndaj librave sillu me dashuri dhe vëmendje.

Çfarë përshëndetje kulturore duhet të përdorësh në shkollë?
Si duhet të kujdesesh për librat dhe mjetet shkollore?
Si duhet të veprosh kur mësimdhënësi shpjegon?
Pse duhet të respektohen këshillat dhe udhëzimet e mësimdhënësit?

Respekto mësimdhënësin tënd dhe dëgjo këshillat e tij.
Kjo do të të ndihmojë të bëhesh nxënës i mirë.

Lojë e propozuar: Pantomimë — rregullat e shkollës.

Çfarë do të thotë të jesh nxënës?

Që nga dita që shkon në shkollë, ti bëhesh nxënës.

Cili është roli yt në shkollë?
Çfarë bën në shkollë?
Me kë e kalon kohën në shkollë?

Nxënësi do të mësojë shumë gjëra të reja kur shkon në shkollë.



Nxënës i mirë e zbaton dhe e tregon atë që ka mësuar.

Përshkruaj çfarë bëjnë nxënësit në figurë.

Çfarë lloj nxënësi je nëse vjen në shkollë në kohë?
Për cilin nxënës themi se është i vlefshëm?

Si duhet të sillesh me shokët e tu kur bën ndonjë aktivitet të përbashkët?

Nxënësit dhe mësimdhënësit kanë përgjegjësitë e tyre

Bëhu nxënës i përgjegjshëm dhe përfundoji detyrat e tua në kohë.
Kështu do të jesh i suksesshëm në mësim.

Përshkruaj figurën?
Çfarë bëjnë nxënësit dhe çfarë bën mësuesja?
Cilat janë përgjegjësitë e nxënësve dhe cilat të mësueses në figurë?
A punoni në grupe në klasën tënde?
Numëro rregullat të cilat duhen të respektohen kur punon në grup.

Lojë e propozuar me role: Nxënësi dhe mësimdhënësi.

ÇFARË MËSOVA
VLERËSOJE VETEN TËNDE

Ngjyrose yllin sipas suksesit të arritur.

Unë di dhe mundem.

Duhet të punoj pak më shumë.

Kam nevojë për ndihmë.

- Mund të emërtoj shkollën dhe klasën ku mësoj.
- I njoh hapësirat e shkollës dhe lehtë gjendem në to.
- Mund të kujdesem për rregullimin dhe higjienën në klasë.
- I di dhe i respektoj rregullat e sjelljes në klasë, shkollë dhe oborr të shkollës.
- E di që roli i mësimdhënësit është të na mësojë lëndë të ndryshme dhe të na mësojë gjëra të tjera të rëndësishme në jetë.
- I di përgjegjësitë e mia si nxënës.

TEMA 3
SHTËPIA IME

Në këtë temë do të mësojmë për:

- Shtëpinë dhe familjen
- Rolet dhe përgjegjësitë në shtëpi
- Aktivitetet e ditës

Shtëpia dhe familja

Shtëpia ku jetoj

Në çfarë objekti jeton, në shtëpi apo në banesë?
Çfarë ka në oborrin tënd rreth shtëpisë apo rreth ndërtesës?



Sa familje mund të jetojnë në shtëpi dhe sa në ndërtesë, në figurat më lart?
Në çka është e ngjashme shtëpia jote dhe si ndryshon nga shtëpitë e paraqitura në figura?

Përshkruaje shtëpinë ku jeton.

Hapësirat në shtëpi

Emërtoji hapësirat në shtëpinë tënde.



Çdo hapësirë në shtëpi ka dedikimin e vet.

Nga sa hapësira përbëhet shtëpia e paraqitur në figurë?
Numëro mobiljet në secilën nga hapësirat në figurë.
Ku përgatitet ushqimi?
Ku familja shikon televizor?

Sa hapësira ka në shtëpinë tënde?
Për çfarë shërben çdo hapësirë në shtëpinë tënde?
Në cilën hapësirë të shtëpisë e kalon pjesën më të madhe të kohës së lirë?

Llojet e familjeve

Familjet janë të ndryshme, por në të gjitha duhet të ketë dashuri dhe mirëkuptim. Çdo familje është me vlerë të njëjtë.

Familja më e gjerë

Ka edhe lloje të tjera të familjeve, si për shembull, familjet për kujdes dhe familjet kujdestare.

Figurat tregojnë lloje të ndryshme të familjeve. Emërto llojet e familjeve që janë përfaqësuar dhe numëro sa anëtarë ka në secilën prej tyre.
Çfarë kanë të përbashkët të gjitha familjet?

Lojë e propozuar: Rolet familjare.

Emërto anëtarët e familjes në figurë.
Emërto anëtarët e familjes tënde.

Sa anëtarë ka familja jote?
Kush kujdeset për fëmijët në familje?
Si ndihesh në familjen tënde?

Çdo fëmijë ka nevojë për familje.

Anëtarët e familjes

Në figurë është përfaqësuar një familje më e gjerë. Sa fëmijë kanë nëna dhe babai?

Vajza me bluzë të gjelbër është motra e babait të fëmijëve. Çfarë është ajo për fëmijët?

Emërto të afërmit në figurë.
Numëro anëtarët e familjes së paraqitur në figurë.

Lojë e propozuar: Qëllo marrëdhëniet familjare.

Rolet dhe përgjegjësitë në shtëpi

Shiko figurat dhe përshkruaj kush çfarë bën.

Shpjego çfarë obligime kanë anëtarët e familjes tënde në shtëpinë tënde. Cilat janë obligimet e tua?

Pse është e rëndësishme të kujdesemi, që shtëpia në të cilën jetojmë është e rregulluar dhe e pastër?

Pastërtia është gjysma e shëndetit.

Çfarë bëjnë anëtarët e familjes?
Si e ndihmojnë njëri-tjetrin?

Si ndihmohen anëtarët e familjes tënde?
Kush punon më shumë në shtëpi, anëtarët e familjes meshkuj apo femra? A është e drejtë të ketë ndarje të punëve të meshkujve dhe femrave në shtëpi? Pse?

Në shtëpitë tona duhet t'i ndajmë punët dhe të ndihmohemi së bashku.

Respektimi i ndërsjellë në shtëpi

Pse është e rëndësishme të kemi respekt të ndërsjellë midis anëtarëve të familjes? Si e tregon respektin tënd për ta?

Krahaso figurat dhe përshkruaj çfarë vëren.

Në çka ndryshojnë veprimet e anëtarëve të familjes?
Cilat rregulla duhet t'i respektosh në shtëpinë tënde?
A bën zhurmë kur anëtarët e familjes tënde janë duke pushuar?

Të gjithë anëtarët e familjes ose komunitetit duhet të respektohen.

Mbajtja e higjienës personale me përdorim të përgjegjshëm të ujit

Sa herë në ditë i lan duart?
A e lë ujin të rrjedhë derisa i lan duart me sapun?



Vështro dhe përshkruaj si e mbajnë fëmijët higjienën personale?
Kush e përdor ujin si duhet?

Si e ruan ti higjienën tënde personale?
A ke gjëra të tua për mbajtje të higjienës personale?

Pse duhet të kursehet uji?

Uji është shumë i vlefshëm, prandaj duhet të kursehet.

Ndarja e mbeturinave nga shtëpia

Si veproni me mbeturinat në shtëpinë tënde?

Shiko dhe përshkruaj çfarë ndodh në figurë.

Çfarë hedh fëmija në koshin e kaltër, e çfarë në koshin e gjelbër, të verdhë dhe të kuq?

Ku përfundojnë mbeturinat nga shtëpia jote?



Mbeturinat duhet të hidhen në kosh
të përshtatshëm për mbeturina.

Aktivitetet gjatë ditës

Cilat aktivitete i bën gjatë ditës?

Çdo ditë nëna dhe babai im shkojnë në punë.

Gjatë ditës gjyshi dhe gjyshja ime punojnë në kopsht.

Çdo mëngjes shkoj në shkollë, kurse kthehem në mesditë.

Motra ime gjatë ditës është në çerdhe të fëmijëve.

Ku shkojnë çdo ditë babai dhe nëna e fëmijës në figurë?
Përshkruaj çfarë bëjnë anëtarët e tjerë të familjes gjatë ditës.

Në mbrëmje me familjen time shikojmë televizion dhe bisedojmë.

Gjatë ditës luaj me shokët e mi të lagjes.

Çdo mbrëmje babai më lexon përralla.

Gjatë natës unë dhe motra ime flemë. Shkojmë në shtrat rreth orës 9.

Kur shikon familja e vajzës televizion?
Kur dëgjon vajza përralla?
Çfarë bëjnë motrat gjatë natës?

Kur shkon në shkollë?
Në cilën pjesë të ditës shikon libra me ilustrime apo luan lojëra?
Çfarë bëjnë gjatë ditës anëtarët e familjes tënde?
Cilat aktivitete i planifikon për të shtunën e ardhshme?
Pse duhet të planifikohen aktivitete për çdo ditë?

Koha ime e lirë

Si e organizon kohën tënde të lirë?

Koha e lirë është koha për të dëgjuar muzikë, për të vizatuar, për të luajtur sport, për të luajtur lojëra me miqtë, për të punuar në oborr, për shëtitje, për të vizituar të afërmit dhe miqtë, për të ngarë biçikletë, koha për piknik, alpinizëm, etj.

VIZATIM

KALIMI I KOHËS ME KAFSHËT

NË BIÇIKLETË

ME FAMILJEN



Shiko figurat dhe përgjigju:
Çfarë bëjnë fëmijët dhe të rriturit në kohën e tyre të lirë?

ECJE NË KËMBË

ALPINIZËM

SHOQËRIM

PATINAZH NË AKULL

Përshkruaj çfarë bën në kohën tënde të lirë çdo ditë të javës?
Cili është aktiviteti yt i preferuar në kohën tënde të lirë?

ÇFARË MËSOVA
VLERËSOJE VETEN TËNDE

Ngjyrose yllin sipas suksesit të arritur.

Unë di dhe mundem.

Duhet të punoj pak më shumë.

Kam nevojë për ndihmë.

- Di t'i numëroj hapësirat në shtëpinë time dhe për çfarë përdoren ato.
- E di se nga sa anëtarë përbëhet familja ime dhe i kuptoj lidhjet familjare.
- E di se ka lloje të ndryshme të familjeve.
- Mund të kujdesem për higjienën time personale dhe ta përdor ujin me përgjegjësi.
- E di rolin e anëtarëve të familjes në ruajtjen e higjienës në shtëpi.
- I dalloj punët dhe përgjegjësitë e të rriturve dhe fëmijëve në familje dhe në shtëpi, pa dallim të punëve mes meshkujve dhe femrave.
- Di të numëroj aktivitete të mia dhe aktivitete të anëtarëve të familjes gjatë ditës.
- Di mënyra të ndryshme për organizim të kohës sime të lirë.

TEMA 4

VENDI NË TË CILIN JETOJ

Në këtë temë do të mësojmë për:

- Qytetin/fshatin dhe shtetin tim
- Luaj i sigurt dhe orientohem në hapësirë
- Lëviz i sigurt dhe marr pjesë në trafik

Qyteti/fshati dhe shteti im

Shtëpia në të cilën jetoj

Ku jeton Senada?
Si duket qyteti ku ajo jeton?

Ku jeton Mihaili?
Si duket fshati ku jeton ai?

Njerëzit jetojnë në qytete dhe në fshatra.

QYTETI është vendbanim më i madh.

FSHATI është vendbanim më i vogël.

ÇDO VEND I JETESËS KA BUKURITË E TIJ!

Cili është emri i vendit tënd të jetesës?
Sipas madhësisë çfarë vend i jetesës është ai?

Përshkruaj vendin tënd të jetesës!

Shteti im

Ne jetojmë në
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.

Si quhet shteti yt?
Çfarë ngjyra ka flamuri i Republikës së Maqedonisë së Veriut?

Çfarë përfaqëson ngjyra e verdhë?

Vendose gishtin në tregun që tregohet në figurë. Kur mësimdhënësi fillon të lexojë, dëgjo me kujdes. Përcill se ku ka qenë Anja dhe çfarë ka vizituar ajo. Lëvize gishtin në vendet që do t'i dëgjosh.

SHËTITJA E ANJËS

Një mëngjes Anja dhe nëna e saj shkuan në treg. Ato donin të blinin shumë pemë dhe perime. Pasi blenë gjithçka, vazhduan rrugën pranë ambulancës dhe hynë në barnatore. Aty blenë barna për gjyshen e saj. Pastaj shkuan në shitore ku blenë qumësht.

Anja ishte shumë e vlefshme atë ditë. Përveç që i ndihmoi nënës së saj, ajo mësoi edhe për objektet në rrethinën e saj. E ato janë: TREGU, SHITORJA, AMBULANCA dhe BARNATORJA.

Cilat objekte i vizitoi Anja? Numëroi ato!
Çfarë blenë Anja dhe nëna e saj në treg?
Ku e blenë qumështin?
Me çfarë shenje e njihni ambulancën?
Ku i blejmë barnat?

Çfarë objekte ka në vendin ku jeton?
Për çfarë u shërbejnë ato njerëzve?

Profesionet e njerëzve

Shihe çdo figurë dhe trego kush ku punon.

Ku shkojmë kur jemi të sëmurë? Çfarë ngjyre janë rrobat e punës së mjekes në figurë?
Çfarë bën infermierja? Kujt i ndihmon ajo?
Përshkruaje uniformën e policit.
Çfarë bën zjarrfikësi?



ÇFARË DËSHIRON TË BËHESH KUR TË RRITESH?

Ja se çfarë duan të bëhen shokët e tu!

Cilat profesione i zgjodhën shokët e tu?
Mendo se çfarë dëshiron të bëhesh kur të rritesh? Pse?

Lojë e propozuar: Çfarë dua të bëhem?

Unë luaj i sigurt dhe orientohem në hapësirë

Ku duhet të luash kur je jashtë?

VENDE TË SIGURTA PËR TË LUAJTUR





Si janë këto vende për të luajtur?
Cili është vendi yt i preferuar për të luajtur kur je jashtë? Ku gjendet?
Përshkruaj çfarë është vend i sigurt për të luajtur!

Shihi mirë figurat e mëposhtme.
Çfarë sheh në to?

VENDE TË PASIGURTA PËR TË LUAJTUR



Pse është rrezik të luhet në këto vende?
Çfarë mund të ndodhë nëse luan në rrugë?
Çfarë mendon, pse vendi i ndërtimit nuk është vend ku fëmijët luajnë?

Unë lëviz i sigurt dhe marr pjesë në trafik

Dëgjoni një këngë në temën "Trafiku".

Shihe figurën me kujdes. Çfarë sheh?

Të gjithë jemi pjesëmarrës në TRAFIK.
Edhe ti je pjesë e trafikut në rrethinën tënde.

Shiko me kujdes figurën dhe vlerëso se të gjithë pjesëmarrësit në trafik a veprojnë si duhet. Ku e kalojnë rrugën nëna dhe fëmija?
Kush lëviz nëpër trotuar? Çfarë janë ata në trafik?
Ku lëvizin çiklistët?
Si quhet pjesa ku lëvizin automobilat?



SEMAFORI

Semafor ndizu-fiku.
Me të KUQEN thotë ndalo!
Prit sinjalin pastaj ik...
Me te VERDHËN përgatitu.
Me të GJELBRËN shpejt kalo.

Kur në rrugë ka shumë trafik
dhe të thotë polici prit.
Mos u nxito, mos u mërzit.
Prit sinjalin pastaj ik.

Nuk u lodhe semafor,
plot njëzet e katër orë.
Ti në qytetin tonë gazmor.
Qarkullimin ke në dorë.

Dihet që nga klasa e parë,
që të bëhesh djalë i mbarë,
Po të jesh një kalimtar,
do kalosh në trotuar.



Çfarë është semafori?
Sa ngjyra ka ai?
Çfarë do të thotë secila prej tyre?

Çfarë ngjyrë dhe formë kanë shenjat e trafikut në figurë?
Çfarë tregojnë këto shenja të trafikut?

Pse është e rëndësishme të dihet kuptimi i shenjave të trafikut?
Kush duhet t'i respektojë shenjat e trafikut?

SHENJAT E TRAFIKUT DUHET TË RESPEKTOHEN.

Lëvizja e sigurt dhe e pasigurt në trafik

Shiko figurat dhe zbulo se cila nga situatat e dhëna të trafikut është e sigurt dhe cila është e pasigurt.



Në TRAFIK ka rregulla. Nëse i respekton ato, do të jesh pjesëmarrës i sigurt. Kur nuk i respekton rregullat e trafikut, ti gjendesh në situatë të pasigurt.

Ku e kalon këmbësori rrugën i sigurt?
Në çfarë situate gjendet çiklisti, i cili lëviz në rrugë?
Si vepron shoferi, i cili qëndron në semafor të kuq me automobilin e tij?
Shiko figurat dhe shpjego kush është në situatë të pasigurt?

SJELLJA E SIGURT

- **Ndalo.**
- **Shiko majtas,** pastaj djathtas.
- Kur je i sigurt se nuk ka automjet - **kalo**.





Kur këmbësori kalon rrugën,
në fillim shikon majtas, pastaj djathtas!

Gjëja më e rëndësishme është të mësosh dhe të dish të kalosh rrugën në mënyrë korrekte dhe të sigurt. Edhe në këtë moshë atë duhet ta bësh në prani të të rriturit.

Lojë e propozuar: Shiko majtas - shiko djathtas.

Automjetet me përparësi kalimi

Në rrugë shohim dhe takojmë automjete të ndryshme.
Automjetet që kanë sinjale të dritës dhe të zërit janë të ndryshme.
Ato u ndihmojnë njerëzve në situata të caktuara.
Mund të kërkohen në numrat e mëposhtëm të telefonit.

POLICIA

ZJARRFIKËSI

NDIHMA E PARË



Çfarë ngjyre është automjeti i policisë? Çfarë bën polici në figurë? Në cilën situatë thirret zjarrfikësi dhe në cilin numër duhet të telefonosh? Kë e dërgon ndihma e parë? Si e njeh automjetin e ndihmës së parë? Në cilin numër mund t'i telefonosh në rast urgjent? Pse këto automjete gjithmonë kanë përparësi kalimi?

Mendo! Nëse do të kishe mundësi që të takosh policin, zjarrfikësin ose mjekun e ndihmës së parë, çfarë do të doje t'i pyesësh dhe të mësosh për punën e tyre?

Në klasë thirrni të ftuar (polic, zjarrfikës, infermiere ose mjek të ndihmës së parë), i cili do të tregojë ndonjë ngjarje interesante nga puna e tij.

ÇFARË MËSOVA
VLERËSOJE VETEN TËNDE

Ngjyrose yllin sipas suksesit të arritur.

Unë di dhe mundem.

Duhet të punoj pak më shumë.

Kam nevojë për ndihmë.

- Di të emërtoj vendbanimin tim. I njoh objektet më të rëndësishme në të. E di se për çfarë shërbejnë ato.
- Di të emërtoj vendin tim dhe të njoh flamurin e tij.
- I dalloj profesionet: shitës, mjek, infermier, farmacist.
- Unë njoh vende të sigurta për të luajtur.
- E dalloj rrugën, vendkalimin, trotuarin, udhëkryqin dhe shtegun për biçikleta.
- I njoh semaforin dhe shenjat kryesore të trafikut.
- I njoh dhe i respektoj rregullat kryesore për lëvizje të sigurt në trafik.
- I di numrat e telefonit dhe rolin e ndihmës së parë, policisë dhe zjarrfikësit.

LOJRA

- Qëlloje muajin
- Cilësitë tona pozitive
- Eja t'i tregojmë ndjenjat!
- Ndiqi udhëzimet dhe mbërri deri te caku
- Pantomimë
- Nxënësi dhe mësimdhënësi
- Qëllo marrëdhëniet familjare
- Rolet familjare
- Pantomimë – profesioni
- Shiko majtas – shiko djathtas!

UDHËZIME PËR LOJRAT

Qëllo muajin.

Renditunі në rreth. Një nxënës duhet të qëndrojë në mes, me top në duar. Ai thotë një muaj dhe ia hedh topin një nxënësi tjetër. Kushdo që e kap topin duhet ta thotë muajin tjetër. Nëse e qëllon muajin, ndalet në mes të rrethit dhe ia hedh topin tjetrit. Loja mund të luhet në disa mënyra, për shembull, qëllohet muaji që i paraprin atij të përmendur ose qëllohet emri i muajit që fillon me shkronjë të caktuar, etj..... (Faqja 11)

Cilësitë tona pozitive. Nxënësit ulen në rreth, në mes një fëmijë tregon për një nga cilësitë e tij pozitive. Më pas ai emërton një fëmijë tjetër sipas zgjedhjes së tij, i cili ulet në mes dhe tregon cilësinë e tij pozitive. Loja vazhdon me fëmijën tjetër..... (Faqja 13)

Eja t'i tregojmë ndjenjat! Nxënësit bëjnë shprehje të fytyrës sipas fjalës që thotë mësimdhënësi (P.sh. GËZIM...) dhe më pas vizatojnë fytyrë në fletë ngjitëse, që tregon se si ndihen në këtë moment. Fletët i ngjitin në tabelë dhe secili tregon pse e ka vizatuar atë. Bëhet bisedë se cila ndjenjë ndikon më tepër..... (Faqja 25)

Ndiqi udhëzimet dhe mbërri deti te caku. Caktoni nga cila hapësirë duhet fëmija të dalë që të shkojë në hapësirë tjetër, që do ta zgjidhni pa ia treguar. Jepni udhëzime SHKO DREJT, KTHEU MAJTAS, KTHEHU DJATHTAS, DIL... Luani kështu edhe me shokët e klasës.

Njëri jep udhëzime, tjetri i kryen dhe e qëllon cakun deri ku duhet të mbërrijë ..... (Faqja 39)

Pantomimë - rregullat e shkollës. Mësimdhënësi zgjedh nga simbolet e ofruara në poster. Shembull, ngre dy gishta, kurse nxënësit e qëllojnë rregullin. Mund të luhet edhe anasjelltas. Mësimdhënësi thotë ndonjë rregull, kurse nxënësit e tregojnë atë ..... (Faqja 47)

Nxënësi dhe mësimdhënësi. Paraqitni situatë të përditshme në klasën tuaj. Ndërroni rolet e nxënësit dhe mësimdhënësit..... (Faqja 51)

Qëllo marrëdhëniet familjare. Nxënësit i emërtojnë të afërmit e tyre nëpërmjet pyetjeve të mëposhtme:

- Gjyshja dhe gjyshi yt për nënën tënde janë...
- Prindërit e babait tënd i emërton si...
- Si e quan vëllain e babait tënd?
- Motrën e nënës tënde, ti e ke...

Nxënësit vetë bëjnë pyetje të ngjashme, kurse nxënësi tjetër ia qëllon. Ai nxënës që ia qëllon, mendon pyetje dhe kështu loja vazhdon.

Jepni mundësi nxënësve të zgjedhin atë që duan ta tregojnë.
..... (Faqe 57)

Rolet familjare. Në klasë dramatizoni rolet familjare. (Faqja 59)

Pantomimë: Çfarë dua të bëhem? Nxënësi zgjedh një profesion. Ndalet në vend të caktuar dhe përmes lëvizjeve të trupit përpiqet t'u shpjegojë shokëve të klasës profesionin që kishte parashikuar. Vendin e zë nxënësi që e qëllon i pari profesionin **.....** (Faqja 77)

Shiko majtas - shiko djathtas! Simulo lojë për kalim të duhur në rrugë duke përdorur termat SHIKO MAJTAS – SHIKO DJATHTAS. Loja mund të luhet në klasë ose në oborrin e shkollës.

.....(Faqe 85)

PËRMBAJTJA

Hyrje 3

Simbolet 4

Tema 1: UNË JAM FËMIJË 5

Kush jam unë 6
- Ditëlindja ime 8
- Muajt e vitit 10

Çfarë më pëlqen te vetja? 12

Çfarë mund të bëj tani dhe çfarë do të mund të bëj në të ardhmen 14
- Ditët e javës (dje, sot, nesër) 16
- I zhvilloj shkathtësitë dhe aftësitë e mia 18
- Veprimet e gabuara 20

Ndjenjat e mia 22
- Si ndihem kur 24
- Çka është dashuria? 26

Shokët dhe shoqet e mia 28
- Eja të luajmë dhe të shoqërohemi 30

ÇFARË MËSOVA 32

Tema 2: UNË JAM NXËNËS 33

Klasa dhe shkolla jonë 34
- Unë jam nxënës 34
- Shkolla ime 35
- Klasa ime 36

Hapësirat në shkollë 38
Si kujdesemi për klasën, shkollën dhe oborrin e shkollës? 40
Rregullat dhe përgjegjësitë e shkollës 42
Festa e patronatit të shkollës 44

Ne nxënësit dhe mësimdhënësi ynë 46
Mësimdhënësi im 46
Çfarë do tëthotë të jesh nxënës? 48
Nxënësit dhe mësimdhënësit kanë përgjegjësitë e tyre 50

ÇFARË MËSOVA 52

Tema 3: SHTËPIA IME 53

Shtëpia dhe familja 54
Shtëpia ku jetoj 54
Hapësirat në shtëpi 55
Llojet e familjeve 56
Familja ime 58
Anëtarët e familjes 59

Rolet dhe përgjegjësitë në shtëpi 60
Respektimi i ndërsjellë në shtëpi 62
Mbajtja e higjienës personale me përdorim të përgjegjshëm të ujit 63
Ndarja e mbeturinave nga shtëpia 64

Aktivitetet gjatë ditës 66
Koha ime e lirë 68

ÇFARË MËSOVA 70

Tema 4: VENDI NË TË CILIN JETOJ 71

Qyteti/fshati dhe shteti im 72
Shtëpia në të cilën jetoj 72
Shteti im 73

Objektet në rrethinën time 74

Profesionet e njerëzve 76

Unë luaj i sigurt dhe orientohem në hapësirë 78

Unë lëviz i sigurt dhe marr pjesë në trafik 80
Shenjat e trafikut dhe semafori 82

Lëvizja e sigurt dhe e pasigurt në trafik 84

Automjetet me përparësi kalimi 86

ÇFARË MËSOVA 88

Udhëzime për lojrat 90

Profesionetenjerëzve 76